

VENDIM
Nr. 334, datë 25.4.2013

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E
BRENDSHME, PËR PËRBALLIMIN E SHPENZIMEVE TË TRANSPORTIT DHE
SHPENZIMEVE TË TJERA TË LIDHURA ME HUMBJEN E JETËS
SË ZONJËS LINDA IHSANI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për buxhetin e vitit 2013”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, zëri “Shpenzime operative”, t’i shtohet fondi prej 980 000 (nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të transportit, për kthimin në atdhe nga Ankaraja (Turqi), si dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me humbjen e jetës së zonjës Linda Ihsani.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Pagesa të bëhet kundrejt paraqitjes së faturave origjinale të institucionit.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha